

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË  
(PROCEDURË E HAPUR)  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM.**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Pastrimi i mbetjeve të ngurta të akumuluar në bieftin e poshtëm në HEC Fierzë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punë ndërtimi 45000000-7.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 19,999,960 (Nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Njësia e Prodhimit HEC FIERZË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklaratimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, citohet: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 (*Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për

paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

#### **- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël

se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1/A Punime gërmimi në tokë.
- N.P - 8/A Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje
- N.P - 9/A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
- N.P - 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit

#### PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 18/ A Punime topogjeodezike
- N.S - 20/ A Punime gjeologo -inxhinierike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose Europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit dhe argumentojmë si më poshtë:

**N.P 1/A** - Punime gjurmimi në tokë

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me gjurmimi sipas projektit të zbatimit.

**N.P 8/A** - Ndertime detare dhe punime thellimi në ujë

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me gjurmimi në prani uji. Punimet që zhvillohen në prani uji kërkojnë ekspertizë specifike teknike që nuk mbulohen nga licencat e zakonshme të ndertimit civil.

**N.P 9/A** - Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime me ndërhyrje në infrastruktura hidraulike, mbrojtje lumore apo sisteme kullimi/bonifikimi që kërkojnë njohuri specifike mbi sjelljen e ujerave, eroionin, rrjedhjet dhe stabilitetin e strukturave mbrojtëse.

**N.P 12/A** - Punime të inxhinierisë së mjedisit

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime të veçanta të shpërndara në territor dhe vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme sipas projektit të zbatimit.

**N.S - 18/A** - Punime topogjeodezike

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me zbatimin e rievimeve topografike, punimeve topogjeodezike që lidhen konkretisht me kuotat e gjurmimit sipas projektit të zbatimit .

**N.S - 20/A** - Punime gjeologjike -inxhinierike

Në këtë projekt zbatimi përfshihen vlerësimit e rrjedhjet të ngurta, qëndrueshmëria e bazamenteve për gjurmimet dhe sistemimi i rrjedhës së lumit me aktivitetet të lartë erozional, dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kemi një analizë gjeologjike dhe gjeologjike -inxhinierike të vazhdueshme të vendit ku do të bëhen këto punime.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi licenca/leje të lëshuara nga QKB si më poshtë:

- Licencë kategoria III.2.B - Grumbullim, ruajtje/magazininim, rikuperim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme,

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10431, date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”.

Licenca kategoria III.2.B - Grumbullim, ruajtje/magazinim, rikuperim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, është kërkuar në përputhje me projekt preventivin e zbatimit dhe bazuar në raportin e vlerësimit të mjedisit hartuar nga projektuesi ku specifikohet qartë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit dhe mënyra e menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë proceset e grumbullimit, ruajtjes/magazinimit, rikuperimit dhe transportimin e mbetjeve të llojeve të ndryshme. Projekti është i lidhur me zvogëlimin e efekteve të grumbullimit të aluvioneve dhe mbetjeve të ngurta në liqen .

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë staf punonjësish prej minimalisht 25 ( njëzet e pesë ) punonjës për periudhën (Shkurt 2026 – Prill 2026):

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Shkurt 2026 – Prill 2026).

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 (njëzet e pesë )punonjës është në përputhje me objektin e prokurimit, rëndësisë së veprës, afatit kohor, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës, shpërndarjen e objekteve dhe fronteve të punës si dhe përcaktimit të numrit të punonjësve të kryer nga projektuesi. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet te jete minimalisht 25 (njëzet e pesë )punonjës.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me lis pagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

**2.3.5** Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar të përfshirë në licensën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Shkurt 2026 – Prill 2026), stafi inxhinierik si më poshtë:

- + minimalisht 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- + minimalisht 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- + minimalisht 1(një) Inxhinier Mjedisi
- + minimalisht 1(një) Inxhinier Topograf
- + minimalisht 1(një) Inxhinier Gjeolog

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- CV,
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Gusht 2024;

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

#### **Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:**

Për sa i takon inxhinierit të ndërtimit, është kërkuar pasi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të nëntokës sipas zërave të preventivit të punimeve. Ky inxhinier duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e bazamentit ku do të germohet.

Për sa i takon inxhinierit Hidroteknik është kërkuar referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, pasi duhet të bejë gjithë punën e nevojshme për të ulur dhe kontrolluar nivelet e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore , presionin hidrostatik për të lejuar gjitha gjërmimet

Për sa i takon Inxhinierit te Mjedisit referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, janë parashikuar punime të veçanta të shpërndara në territor dhe vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme sipas projektit të zbatimit, si dhe garantojë depozitim të materialeve që dalin nga gjërmimet në vend depozitim të sigurt dhe që janë konform kushteve mjedisore dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Për sa i takon Inxhinierit gjeodet, është kërkuar pasi inxhinieri topograf do të jetë pjesë aktive e procesit të zbatimit të projektit duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet gjeodezike, kuotat dhe koordinatat për të gjitha punimet e zbatimit që janë parashikuar në preventivin e punimeve, të gjitha punimet e zbatimit të fushës gjeodezike, i rilevimit topografik të zonës së sistemit etj.

Për sa i takon Inxhinierit gjeolog, i specializuar në fushën e gjeologjisë inxhinerike ka për detyrë vlerësimin gjeologjik dhe gjeoteknik të vendeve ku do të gërmohet , granulometria e materialeve lumore, cilësinë e tyre në varësi të projektit . Të vlerësojë dhe studiojë zonën me qëndrueshmëri të ulët dhe aktivitetin erozional dhe akumulues gjatë fazës së projekt zbatimit.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij ose me kontratë shërbimi/bashkëpunimi, 3 (tre) polumbarë të certifikuar për zhytje në ujra të embla për periudhën Shkurt 2026- Prill 2026.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratat shërbimi/bashkëpunimi të vlefshme;
- ✚ Certifikatat përkatëse;

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

Referuar objektit të specifikimeve teknike, punimet për pastrimi i mbetjeve të ngurta , do të realizohen nën ujë. Për të garantuar vazhdimësinë e punimeve gjatë zbatimit të punimeve OE duhet

të ketë të paktën 3 (tre) polumbare. Ky kriter lidhet ngushtësisht me pjesën ku do të kryhen punimet, pasi polumbarët gjatë zbatimit të punimeve do të kryjnë kontrolle nën ujore, për ruajtjen e pjesës takuese të shtratit të betonit dhe terrenit natyror. 3 (tre) polumbare janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që do të kryhen duke marrë parasysh shtrirjen e madhe dhe të terrenit të zbatimit dhe relievin e vështirë ku do punohet si dhe mund të ndajnë detyrat në mënyrë që të kryhen veprime të ndryshme në të njëjtën kohë.

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026 punonjesit teknik si më poshtë:

- ✚ 1 (një) Teknik Topograf – Hidroteknik
- ✚ 15 (pesëmbëdhjete) Punëtor krahu ndertimi
- ✚ 1 (një) Manavrator
- ✚ 2 (dy) Eskavatorist
- ✚ 3 (tre) Shofer/Drejtues makinerish

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- ✚ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Gusht 2024;
- ✚ Certifikatat/Diploma përkatëse ose ekuivalent ;

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Për sa i takon stafit të kërkuar në këtë kriter, janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që do të kryhen duke marrë parasysh shtrirjen e madhe dhe të terrenit të zbatimit dhe relievin e vështirë ku do punohet.

Për shkak të natyrës specifike dhe vendit ku do të kryhen punimet, trajnimi i punonjësve dhe pajisja e tyre më dëshminë për kualifikimin Certifikatat / diplomë të lëshuar nga institucionet kompetente të licencuara sipas Ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, është në përputhje me proceset e punës që parashikohen dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.7/1** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën (Shkurt 2026 – Prill 2026): 1 (nje) punonjes te trajnuar per shendetin ne pune ne perputhje me percaktimet e ligjit Nr.10327,date 18.02.2010( Per sigurine dhe shendetin ne pune) dhe VKM Nr.312 date

05.05.2010 “Per miratimin e rregullores ,per sigurine ne kantier) te paisur me certificate ne lidhje me frekuentimin e kurseve te formimit ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes

### **Argumentimi:**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, shtojca Nr.8.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës*

*Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ ISO 9001 “ Sistemi i menaxhimit të cilësisë ”;
- ✚ ISO 45001 “ Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ”;
- ✚ ISO 14001 “ Sistemi i Menaxhial i Mjedisit ose ekuivalente ”;

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

**ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të realizojë një vizitë në objekt për të inspektuar veprën në përputhje me pikën 2.17 Vizitë në kantier, të dokumenteve standarde të tenderit.

#### **Argumentimi:**

Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një objekt shume specifik, me punime të fshehta nënujore AK e shikon të domosdoshme vizitën në objekt përpara se të ofertohet. Kjo për arsyen se çdo OE i interesuar duhet të jetë i qartë për kushtet që do ketë për realizimin e punimeve.

Vizita në objekt është kusht i domosdoshëm, dhe vizita në kantier do të vërtetohet me një procesverbal sipas përcaktimeve në pikën 2.17 Vizitë në kantier, të dokumenteve standarde të tenderit.

**2.3.10** Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Mjetet /Pajisjet</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Statusi</b>
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-18 ton	Copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator krah gjate deri ne 18 ml	Copë	1	Pronësi ose me qera
Fadrome me Goma (kove perpara, kove mbrapa)	Copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator/Minieskavator me zinxhir gome	Copë	1	Pronësi ose me qera
Platform për mbajtjen e makinerive në liqen	Copë	1	Pronësi ose me qera
Paisje industriale per inspektime nenujore (Robot nenujor)	Copë	1	Pronësi ose me qera
Panel zhytjeje me gaz te perzier	Set	1	Pronësi ose me qera

Helmet/maske/tub zhytjeje	Set	1	Pronësi ose me qera
Njesi CCTV full HD	Set	1	Pronësi ose me qera
Bombul zhytjeje	Copë	3	Pronësi ose me qera
Kamera CCTV, ndricim LED 150 m	Copë	1	Pronësi ose me qera
Penda zhytjeje (Diver fins)	Set	3	Pronësi ose me qera
Jelek zhytjesi	Copë	2	Pronësi ose me qera
Kostum zhytjeje	Set	2	Pronësi ose me qera
Dhome dekompressionit	Copë	1	Pronësi ose me qera
Barrele zhytjeje shpetimi	Copë	1	Pronësi ose me qera
Bombul ajri/oksigjeni	Copë	10	Pronësi ose me qera
Rrip zhytjeje	Copë	2	Pronësi ose me qera

**“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh, aktet e zhdoganimit ose faturë tatimore të shitblerjes orgjinale ose fotokopje e noteruar ose kontratë qiraje të noterizuar.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit. Kur janë në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni i automjetit, certifikata e kontrollit teknik.
- c) Për mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- d) Për mjetet të gjith mjetet e mësipërme duhet të paraqes foto te dukshme .

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-18 ton janë të nevojshëm për transportin e materialeve të nxierra nga germimi për nevojat e objektit.
2. Eskavator krah gjatë deri në 18 ml është i nevojshëm për germim në thellesi të objektit .
3. Fadrome me Goma (kove përpara, kove mbrapa) janë të nevojshëm për transporte germime dhe ngarkime të materjalave .
4. Eskavator/Minieskavator me zinxhir gome janë të nevojshëm për ngarkime në mjet të materjaleve të dalura nga germimi
5. Platform për mbajtjen e makinerive në liqen është e nevojshme për qëndrimin e mjeteve të germimit .
6. Pajisje industriale për inspektime nenujore (Robot nenujor) është e nevojshme pasi punimet do të realizohen në prani uji dhe në kushte ku kontrolli vizual i drejtpërdrejtë është i kufizuar, duke përfshirë monitorim të vazhdueshëm të zonës së ndërhyrjes.
7. Panel zhytjeje me gaz të perzier është e nevojshme për të garantuar sigurinë gjatë punimeve me eskavator në prani uji.
8. Helmet/maske/tub zhytjeje, janë të nevojshme pasi punimet do të realizohen në prani uji dhe në angazhimin e polumbareve profesionale, ku kërkohet garantimi i kushteve të sigurt dhe komunikimit gjatë operacioneve nenujore.
9. Njësi CCTV full HD, është e nevojshme për monitorimin në kohë reale të punimeve në prezencë uji duke i dhënë ekipit teknik dhe autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë ecurinë dhe cilësinë e zbatimit të punimeve. Gjithashtu njësi CCTV ndihmon në kontrollin operacional dhe orientimin e ekipit të zhytjes gjatë realizimit të ndërhyrjeve.
10. Bombul zhytjeje, është e nevojshme pasi sigurojnë furnizimin me ajër ose gaz frymemarrjeje për polumbaret gjatë zhvillimit të punimeve, duke garantuar realizimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të operacioneve nenujore.
11. Kamera CCTV, ndricim LED 150 m, është e nevojshme pasi mundëson transmetimin dhe monitorimin në kohë reale të punimeve të kryera nga polumbaret. Në kushtet e punimeve në prani uji ku dukshmeria dhe kontrolli direkt janë të kufizuara, përdorimi i kamerave ndihmon në identifikimin e problematikave apo devijimeve gjatë zbatimit të kontratës.
12. Penda zhytjeje (Diver fins), është e nevojshme për rritjen e efikasitetit të levizjes nën ujë dhe për reduktimin e lodhjes fizike të polumbareve gjatë realizimit të punimeve
13. Jelek zhytjeje, është e nevojshme pasi shërben për kontrollin e notimit të polumbarit duke mundësuar qëndrueshmëri në thellesi dhe pozicionim të saktë gjatë kryerjes së punimeve nenuje.
14. Kostum zhytjeje, është e nevojshme pasi shërben për izolimin termik të trupit, duke mbrojtur polumbarin nga temperaturat e uletë të ujit dhe duke mundësuar qëndrueshmëri gjatë kohezgjatjes së punimeve.
15. Dhoma dekompressionit, është e nevojshme pasi shërben për trajtimin dhe normalizimin gradual të presionit trupor të polumbareve pas daljes nga thellësia duke parandaluar komplikacionet e lidhura me dekompressionin.
16. Barrele zhytjeje shpëtimi, është e nevojshme dhe shërben për transportin e sigurt të polumbarit nga zona e punës në prani uji në sipërfaqe ose në mjetet e trajtimit mjeksor, në rast aksidenti apo gjendje të rënduar shëndetësore.

17. Bombul ajri/oksigeni, eshte e nevojshme dhe standart gjate punimeve ne prani uji dhe lidhet drejteperdrejt me kerkesat e sigurise ne zhytje.
18. Rrip zhytjeje, eshte e nevojshme per balancimin e notimit te polumbarit, duke mundesuar zhytje te qendrueshme gjate realizimit te punimeve duke mundesuar polumbarit te mbaje pozicion te qendrueshem pa konsum te tepert energjie gjate operacioneve.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike- referuar relacionit teknik për punimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij projekti, hartuar nga projektuesi.

Punimet qe do te kryhen jane ne bjeftin e poshtem HEC Fierze, shume afer me sallën e makinerive dhe te gjitha keto punime kerkojne kujdes te vecante dhe duhet te ralizohen me pajisje te vecanta.

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

*Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.*

**Njësia e Prokurimit.**